



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË

V E N D I M

Nr. 22 Datë 10. 04. 2017

“MIRATIM NË PARIM PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR PËR ENERGJI ELEKTRIKE” SUBJEKTIT “ERIM” SH.P.K.

Në mbështetje të nenit 7 pika 2 ,të nenit 50, pikës 2,të ligjit nr 111/2012 dt.15.11.2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”, të VKM Nr.416 datë 13.05.2015 si dhe të nenit 24, pika c, të VKM Nr. 822 datë 07.10.2015, “ Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike , që nuk janë objekt konçesioni”, për paisjen me autorizim të subjektit **“ERIM”sh.p.k.**, me propozim të A.B.U Drin- Bunë, miratimin në parim të Këshillit Konsultativ dhe oponencës së DPBU në ministrinë përgjegjëse për administrimin e burimeve ujore, Këshilli i Basenit Ujor Drin- Bunë,

V e n d o s i:

1-Miratimin në parim të kërkesës së subjektit **“ERIM” SH.P.K.**, me administrator Z.Ismail SHYTI, për përdorim të burimit ujor, **Përroi Hetmit dhe Përroi i Sheshit të Vogël**, degë e Lumit Zalli i Bulqizës, degë e Lumit Drin i Zi , për prodhim energjie elektrike në Fshatin Fushë Bulqizë, Njësia Administrative Fushë Bulqizë , Bashkia Bulqizë, Qarku Dibër.

Sipas studimit të paraqitur nga subjekti HEC SHYTAJ do të ketë këto të dhëna:

Koordinatat e veprës marrjes 1	X ₁ – 44 40 153.08;	Y ₁ – 46 03 783.5;	Z ₁ – +1200.4m
Koordinatat e veprës marrjes 2	X ₂ – 44 40 011.1;	Y ₂ – 46 03 700;	Z ₂ – +1202.6m
Koordinatat e veprës marrjes 3	X ₃ – 44 39 787.5;	Y ₃ – 46 03 265.8;	Z ₃ – +1200 m
Koordinatat e veprës marrjes 4	X ₄ – 44 39 000;	Y ₄ – 46 02 695.2;	Z ₄ – +1220 m
Koordinatat e godinës së centralit:	X – 44 39 939.6;	Y – 46 02 391.6;	Z - +957 m;
Koordinatat e pikës së shkarkimit:	X – 44 39 939.6;	Y – 46 02 391.6;	Z - +957 m;
Prurja mesatare vjetore e burimit :	Q _{1mes} =Q _{2mes} =Q _{3mes} =0.04m ³ /sek;	Q _{4mes} = 0.06m ³ /sek;	
Sasia e ujit që kërkohet të përdoret:	Q _{1llog} = Q _{2llog} =Q _{3llog} = 0.08m ³ /sek;	Q _{4llog} =0.12m ³ /sek;	
Prurja ekologjike:	Q _{1ekol} =Q _{2ekol} =Q _{3ekol} =0.01m ³ /sek;	Q _{4ekol} =0.025m ³ /sek;	
Prurja që shkarkohet:	Q= 0.36 m ³ /sek.		

2- Autorizimi i përdorimit të burimit ujor për prodhim energjie elektrike jepet me kusht që të mos kufizohet furnizimi me ujë të pijshëm, nevojat e bujqësisë në zone dhe rezerva e domosdoshme ekologjike.

3- Ngarkohet A.B.U. Drin-Bunë për zbatimin e këtij vendimi.

PËR KËSHILLIN E BASENIT UJOR DRIN-BUNË
SEKRETAR
Martin PLLUMBI



KRYETAR
Paulin RADOVANI